Suharekë: Rrahë gruan, kur arrestohet i sekuestrohen arma me fishekë

LAJME

16/12/2023 17:28

Është arrestuar një person të premten në fshatin Greikoc të Suharekës pasi dyshohet për veprën penale "Dhunë në familje".

Ai dyshohet se pas një mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij e ka rrahur atë. Gjatë kontrollit në shtëpinë e të dyshuarit, policia ia ka gjetur një armë pa leje.

Po shtu, policia ka konfiskuar edhe: një pistoletë e llojit EKOL specila e kalibrit 9mm, një karikator i armës dhe dymbëdhjetë copë fishekë të kalibrit 7.65 mm.

Njoftimi i plotë:

Arrestohet i dyshuari për dhunë në familje dhe armëmbajtje pa leje

Prizren, 16 dhjetor 2023

Me datën 15.12.2023 Stacioni Policor Suharekë përmes rrugëve operative ka pranuar informacion se në fshatin Greikoc është një rast i dhunës në familje.

Njësitet policore menjëherë i janë përgjigjur thirrjes duke lokalizuar lokacionin, identifikuar dhe arrestuar të dyshuarin i cili dyshohet se pas një mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij ka ushtruar dhunë fizike ndaj saj.

Sektori i hetimeve të Stacionit Policor në Suharekë gjatë hetimit të rastit të dhunës në familje ka gjetur prova se i dyshuari Xh.L. i vitit të lindjes 1963 posedon armë pa leje.

Me leje të prokurorit të shtetit, sektori i hetimeve ka realizuar një kontrolle në shtëpinë e të dyshuarit, ku gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar:

- Një pistoletë e llojit EKOL specila e kalibrit 9mm,
- Një karikator i armës dhe
- Dymbëdhjetë copë fishekë të kalibrit 7.65 mm.

Prokurori i shtetit ndaj të dyshuarit ka lëshuar masën e ndalimit për 48 orë dhe ndaj tij do të ngritët kallëzim penal për veprat penale "Dhunë në familje" dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" .

LAJME TË FUNDIT

Luftë në Detin e Kuq: Shkatërruesi amerikan rrëzoi...

Gjuajtje me armë zjarri në Fushë-Kosovë: Policia arrin në vendin e ngjarjes

Kupchan për veprimet e Qeverisë në Veri: Albin...

Fifi u mor me Julin: la kthen kjo e fundit

Artikuj të ngjashëm

December 16, 2023
Luftë në Detin e Kuq: Shkatërruesi amerikan rrëzoi 14 dronë që...


December 16, 2023
Gjuajtje me armë zjarri në Fushë-Kosovë: Policia arrin në vendin e ngjarjes

December 16, 2023
Kupchan për veprimet e Qeverisë në Veri: Albin Kurti nuk po...

December 16, 2023
Putin edhe zyrtarisht emërohet kandidat i pavarur për president në zgjedhjet...

December 16, 2023
Më 2024 inflacioni do të zbutet, por çmimet jo domosdo

December 16, 2023
Qytetarët me vlerësime të larta për punën e policisë

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy